



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
LIPJAN



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF

Datë/Datum/Date:	20.02.2026
Për/Za/To:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës së Lipjanit
Nga/Od/From:	Shkelzen Hajdini – Drejtor i DSHPS –së
Lënda/Subjecat/Subject:	Raport Mujor – Janar 2026

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur ju lutem gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën 01.01.2026 deri 31.01.2026.

RAPORT MUJOR PËR MUAJIN JANAR 2026

1. Përmbledhje ekzekutive

Edhe një lajm shumë i mirë, QKMF në Lipjan, mbështetur nga projekti AQH, financuar nga SDC, ka filluar procedurat për Certifikimin me ISO Standarde për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH-së.

Fillimi i vitit 2026 është përcjellë me një numër më të madh të pacientëve si pasojë e ardhjes së një numri më të madh të mergimtareve për festat e fundvitit si dhe për të votuar në zgjedhjet qendrore të organizuara në fund të fitit të kaluar.

Në këtë vit, edhe përkundër planifikimeve që kishim bërë, puna ka filluar në QKMF-në e vjetër ngase projektet Rregullimi i Infrastrukturës së Jashtme të Urgjencës dhe QKMFsë dhe Ndërtimi i Objektit të ri të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit nuk kanë përfunduar ende. Punimet në këto dy projekte do të vazhdojnë edhe në vitin 2026. Poashtu, i rrjedhojë, Sektori i Stomatologjisë dhe ai i Gjinekologjisë kanë vazhduar punën përkohësisht në hapësirat e Komunës në Rrugën Isa Olluri.

Objekti i Vjetër të QKMF-së është adaptuar për nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe është i gatshëm për shfytëzim nga PAK me momentin e lirim të tij nga mjekësia familjare.

Nga muaji janar i vitit 2026 Sektori i Laboratorit në QKMF në Lipjan është i gatshëm dhe është furnizuar me reagentë për të ofruar 49 analiza laboratorike, duke shtuar edhe një analizë shtesë, atë të troponinës. Ky test është shumë i rëndësishëm ngase përmes tij bëhet vlerësimi nëse ka dëmtim të muskullit të zemrës. Niveli i lartë i troponinës tek pacienti tregon mundësinë e ndonjë problemi akut kardial. Ky test mundëson intervenimin e hershëm dhe zvogëlimin e rrezikut nga sulmet në zemër të pacientit tek të cilët mjeku dyshon duke u bazuar në simptomat e paraqitura. Ky avancim, ndikon drejtëpërdrejtë në përmirësimin e shëndetit publik në Lipjan dhe në gjepin e qytetarit duke e kursyer atë nga shpenzimet e panevojshme.

2. Punët dhe aktivitetet e realizuara, bazuar në Planin e Punës së DHSPS-së për vitin 2024

Në fillim të këtij muaji kemi hartuar dhe dorëzuar Planin e Punës për vitin 2026. Në këtë plan kemi vendosur objektiva strategjike specifike dhe reale, të matshme dhe të realizueshme me afatet kohore të përcaktuara. Më tutje, secilën specifikë e kemi zbërthyer në aktivitetet më të rëndësishme duke kostuar secilin aktivitet.

Po ashtu, për zyrën e Kryetarit të Komunës së Lipjanit kemi përgatitur Raportin Vjetor për vitin 2025 në të cilin raport kemi pasqyruar punën e institucioneve shëndetësore të KPSH-së në

Komunën e Lipjanit, punën e Qendrës për Punë Sociale, Shtëpisë me Bazë në Komunitet si dhe punën e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Në këtë muaj, kemi bërë planifikimin e nevojave për material laboratorik me qëllim të ruajtjes së nivelit të shërbimeve laboratorike dhe sigurimin e qëndrueshmërisë në ofrimin e 49 analizave.

Bazuar në raportin mujor të QKMF-së, furnizimi me barna dhe material mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë ka qenë i pjesshëm. Jemi përcjellë me mungesë të terapisë me ampulla Dikofenak 75 mg. Furnizimi me këto ampulla ka munguar nga MSh. Nga Ministria e Shëndetësisë në Janar nuk ka pas asnjë furnizim me material apo barna nga lista esenciale. Furnizimi me material shpenzues dhe pajisje laboratorike është realizuar në përputhje me kërkesat e secilit sektor.

Në bazë të raporteve nga intervenimi i shërbimit të urgjencës, të pranuar nga QKMF, në muajin Dhjetor janë shënuar 43 aksidente trafiku. Krahasuar me muajin e kaluar, numri i rasteve të aksidenteve në trafik në këtë muaj ishte më i lartë.

Shuma e të hyrave të inkasuara nga participimi në muajin Janar ka qenë 8,158.00 €.

Përqindja e referimeve të jashtme për në shërbimin sekondar dhe terciar dhe sekondar gjatë këtij muaji ka qenë 9.42% . Kjo përqindje, siç është raportuar nga QKMF, vazhdon të mbetet në kuadër të përqindjes së lejuar për referimet nga KPSH.

Gjatë këtij muaji numri i përgjithshëm i vaksinave të ordinuara në QKMF-Lipjan dhe punkte, sikur shihen e dhe në tabelën e shërbimeve, ka qenë 412.

Në fund të muajit Janar, aparati biokimik është prishur dhe dërguar për servisim. Si pasojë e këtij defekti në aparatin biokimik, analizat laboratorike, AST, ALT, Bilirubin, LDL, HDL dhe CRP nuk janë duke u ofruar përkohësisht deri sa të servisohet aparati në fjalë.

3. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF) gjatë muajit Janar janë kryer 42483 vizita dhe shërbime shëndetësore.

Stafi mjekësorë	Niveli i arsimimit	Meshkuj	Femra	Numri i punëtorëve gjithsej
Specialist të Mjekësisë Familjare	Superior/Specializim nga mjekësia familjare 26	13	13	26
Mjekë të Përgjithshëm	Superior/Master i Mjekësisë së Përgjithshme 20	10	11	21

Doktor i Stomatologjisë	Superior/Master i Stomatologjisë 10	5	5	10
Specialist Radiolog	Superior/Specializim në Radiologji 1	1	0	1
Specialist i Pediatriisë	Superior/Specializim në Pediatri 1	1	0	1
Specialist Gjinekolog-Obstetër	Superior/Specializim në Gjinekologji me Obstetrikë 2	2	0	2
Specialist i Biokimisë	Superior/Specializim në Biokimi-Klinike 1	1	0	1
Teknik Laborant mjekësorë	Bachelor-4, Shkolla e mesme - 8	8	4	12
Infermier/e	Shkolla e mesme= 84 Bachelor=29	17	97	114
Mami	Shkolla e mesme-12	0	12	12
Teknik të stomatologjisë	Shkolla e mesme-6	2	3	5
Teknik të radiologjisë	Shkolla e mesme-3	2	2	4
Punëtor teknik	Shkolla e mesme-19, shkolla e mesme e ulët-4	12	11	23
Punëtor në administratë	Shkollim superior-4 Shkollim i mesëm-4	7	1	8
Numri i punësuarve nga komuniteti jo shumicë	Shkolla e mesme-3	1	2	3
Numri i punëtorëve me nevoja të veçanta	Shkolla Fillore- 2 Shkolla e mesme-2	3	1	4
Gjithsej numri i punëtorëve	Shkollim superior =64, Shkollim bachelor =33, Shkollimi i mesëm=137, Shkollimi i mesëm i ulët = 4	81	159	240

Janar 2026-Vizitat Mjekësore

1	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në QKMF	6732
2	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në Punte	4095
3	Vizita mjekësore Pediatrie	172
4	Vizita mjekësore Gjinekologjike	239
5	Vizita mjekësore Stomatologjike	696
6	Vizita mjekësore Pulmologjike	20

7	Vizita mjekësore Emergjente	5383
8	Vizita në kujdesin Paliative	253
9	Total	17590

Janar 2026- Shërbime Shëndetësore

1	Injeksione	8299
2	Infuzione	4486
3	Pastrim lidhje	1154
4	RTG	375
5	Laborator	2449
6	Lindje	0
7	Largim i Penjve	68
8	Imobilizime të	47
9	Oksigjenoterapi	81
10	EKG	563
11	Mamografi	6
12	USG	59
13	Vizita Shtëpiake me Autoambulancë	170
14	Transport me Autoambulancë	83
15	Vizita në Stacionin Policor	0
16	Vizita në Qendrën e azilit -Magure	2
17	Vizita në qendrën e paraburgimit	32
18	Rrahje	8
19	Këmbësor i lënduar me automjet	1
20	Konstatim vdekje	11
21	Plagosje me armë zjarri	0
22	Thumbim i rrigrave	0
23	Aksidente trafiku	43

24	Dhunë familjare	4
25	Exitus letalis / mortus ad latae	0
26	Këshillimorja	2583
27	Vakcina	412
28	Vaksina për COVID	463
29	Shërbime stomatologjike	1724
30	Referime	1658
31	Inhalime	42
32	Vizita infermiere gjinekologjike	15
33	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjet	4
34	Klasa për nëna	51
33	Gjithsej shërbime	24893

4. Qendra për Punë Sociale QPS

Tabela 1. Shërbimi social: Shërbimet dhe klientët.

Klientët	Numri i rasteve	Shërbimet	Numri i rasteve
Fëmijët e keqtrajtuar- abuzuar (lënë pas dore)	2	Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin.	11
Të mitur në konflikt me ligjin (delikuentët)	8	Shërbime për të rritur me aftësi të kufizuara	1
Klient në nevojë për këshillime martesore.	/	Bashkimi familjar-kthimi në familje	2
Fëmijët jetim	/	Kujdestaria	1
Riintegrim i fëmijëve	/	Shërbime për të moshuarit	2
Fëmijë me sjellje asociale- vështirësi në sjellje	6	Intervenim i Viktimave	/
Fëmijët e braktisur	/	Shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara	27

Të moshuarit në nevojë për shërbime	/	Besimi i fëmijëve dhe mbikëqyrja e vizitave prindërore	7
Klient me aftësi të kufizuara- Të rriturit	1	Ndihmë material për fëmijët me aftësi të kufizuar	/
Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrës prindërore	1	Vlerësimet për të miturit që kërkojnë të hyjnë në martesë	/
Viktima e dhunës në familje	11	Shërbime për fëmijë me sjellje asociale	6
Martesa e të miturve që dëshirojnë të hyjnë në martesë	/	Këshilla Psiko-Sociale	1
Kujdestari për fëmijët e pa shoqëruar (me status të huaj dhe mbrojtje ndërkombëtare)	1	Intervenime gjatë orarit të Kujdestarisë	6
Tentim vrasje	1	Pjesëmarrje në PTHT/GJTHP	2
Kërkesë për kontaktim	3	Përfaqësues të përkohshëm	3
Klient të tjerë në nevojë për shërbime	72	Intervenime te pergjithshme	557
Nr. i Përgjithshëm i Klientëve.	108	Nr. i Përgjithshëm i Shërbimeve	624

Shtojcë: Pagesat e fëmijëve me aftësi të kufizuar për muajin Janar: 188

Tabela 2. Shërbimet e asistencës sociale.

	Aktivitetet	Kategoria 1	Kategoria 2	Gjithsej
APLIKIMI	1.Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë	1	5	6
	Sa prej tyre janë të aprovuara	1	2	3
	Sa janë në shqyrtim	0	3	3
	Sa prej tyre janë të refuzuara	0	0	0
RIAPLIKIMI	2. Numri i rasteve të larguara për mos ri-aplikim.	12	8	20
	2.1 Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar.	53	65	118
	2.2 Numri i rasteve të larguar për mungesë të dokumentacioni.	11	6	17
VERIFIKIMI	3.Numri total i familjeve të verifikuara/ri-verifikuara.	53	65	118

	<i>Sa prej tyre janë aprovuar Koliko od njih je odobreno.</i>	53	65	118
	<i>Sa prej tyre janë. refuzuar/çregjistruar</i>	0	0	0
KOM. MJEKESOR	4. Numri i rasteve të dërguara. në Komision Mjekësor (KM).	52	0	52
	<i>Numri i rasteve të aprovuara nga KM.</i>	42	0	42
	<i>Numri i rasteve të refuzuara nga KM.</i>	5	0	5
	<i>Numri i rasteve të kthira nga KM për kompletim dokumentacioni .</i>	5	0	5
	3.Numri i ankesave të paraqitura nga Shfrytëzuesit .	0	0	0
	<i>A. Në shkallë të parë(I).</i>	0	0	0
	<i>B. Në shkallë të dytë(II)</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave të aprovuara.</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave të refuzuara.</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave në shqyrtim.</i>	0	0	0
	<i>Kontestet në Gjykata.</i>	0	0	0
	<i>a)Kontestet të pranuar.</i>	0	0	0
	<i>b)Konteste të refuzuara.</i>	0	0	0

Raporti financiar për këtë muaj:

Numri i familjeve	Nr. i anëtarëve të familjes	Shuma në €
871	3639	€136.740.00

- Raporti financiar për azilkërkuesit:**

Numri i familjeve	Nr. i anëtarëve të familjes	Shuma në €
25	19	€1,440.00

5. Shtëpia me Bazë në Komunitet

Gjendja shëndetësore e rezidentëve gjatë këtij muaji në përgjithësi ka qenë e mirë.

6. Investimet Kapitale

Projekti Ndërtimi i Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit është duke vazhduar.

Projekti Rregullimi i Infrastrukturës së Jashtme të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit është duke vazhduar.

7. Vështirësitë dhe sfidat

- Sipas raportit të tranuar nga QKMF, furnizimi me barna dhe materiale nga Ministria e Shëndetësisë ka qenë i pjesshëm dhe nuk ka arritur të mbulojë të gjitha nevojat.
- Punimet ndërtimore në rregullimin e oborrit dhe në objektin e ri kanë ndikuar në zvogëlimin e hapësirave të disponueshme për punë, duke krijuar sfida në organizimin e shërbimeve.
- Ka mungesë të stafit teknik dhe atij mbështetës në QKMF, ndërsa një pjesë e stafit ekzistues është në moshë mesatare mbi 55 vjeç. Kjo është duke ndikuar në kapacitetin operacional të QKMF-së.

8. Planifikimi për muajin Shkurt 2026

- Zbatimi i planit të veprimit për vitin 2026,
- Vazhdimi i EVP-së me staf mjekësor,
- Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore.